

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës			
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik		
Titulli i lëndës:	Klinika juridike penale		
Niveli:	Master		
Statusi lëndës:	Zgjedhore		
Viti i studimeve:	2020/21		
Numri i orëve në javë:	2 + 1		
Vlera në kredi – ECTS:	3		
Koha / lokacioni:	E marte 10.00 – 13.30		
Mësimdhënësi i lëndës:	Dr.Azem Hajdari		
Detajet kontaktuese:	Viti I		
Përshkrimi i lëndës	Studimi i lëndës mësimore:” Klinika juridike penale“ u ofron studentëve para së gjithash njohuri praktike për aktivitetin e subjekteve penal procedural lidhur me zbulimin, ndriçimin dhe zgjidhjene çështjes penale. Studimi i rasteve penale i referohet procedurës parapenale, procedurës paraprake (hetimit, ngritjës së aktakuzës dhe kontrollimit të aktakuzës), shqyrtimit gjyqësor, procedurës lidhur me mjetet juridike, procedurave të veçanta etj.		
Qëllimet e lëndës:	Duke shtyrtuar rastet penale nga praktika gjyqësore, studentet përforcojnë dijen e fituar në fushën penale dhe njëherësh zhvillojnë shkathtësit e zbatimit të ligjit në një rast konkret duke u përgaditur kështu për ushtrimin e profesionit të jurisitit përkatësisht profesionit të gjyqtarit, prokurorit, avokatit etj.		
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi të thelluar të studimeve në studimet e Programit Master, synohet që studentet: - nëpërmjet të shqyrtimit të rasteve penale të zhvillojnë aftësitë për analizë të çështjeve faktike dhe ligjore. - gjatë shqyrtimit të rasteve penale të bëjnë dallimin ndërmjet çështjeve juridike dhe çështjeve faktike. - të aftësohohen të interpretojnë dispozitat ligjore dhe drejtë t'i zbatojnë në praktikë.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej

Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	13	13
Punë praktike	1	5	05
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	5	05
Ushtrime në teren	-	-	-
Kollokfiume,seminare	5	5	25
Detyra të shtëpisë	5	5	25
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgaditja përfundimtare për provim	2	15	30
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	1	10	10
Projektet,prezentimet ,etj	1	10	10
Totali	22	98	183

Metodologjia e mësimdhënies:	<p>Metodologjia e mësimdhënies së lëndës do të përfshijë, shqyrtime të rasteve penale, me theks të veçantë në aspektet faktike dhe juridike, debatediskutime rreth rastit konkret. Rastet penale studentëve u jepen me shkrim të paktën një javë para se të shqyrtohen në klasë. Studentet me vete duhet të kenë Kodin penal dhe Kodin e procedurës penale bashkë me literaturën e domosdoshme për zgjidhjen e rastit penal. Në çdo orë të mësimi trajtohet të paktën një rast penal, ashtu që një student analizon dhe e komenton rastin ndërsa të tjerët marrin pjesë duke shtruar pyetje dhe duke bërë komente. Gjatë debateve studentet ushtrohen që ndaj çështjeve që diskutohen të marrin qëndrim të pavarur dhe kritik dhe të propozojnë zgjidhje dhedetyra për të hartuar shkresa të ndryshme penale: kallëzime penale, akte akuzuese dhe akte gjyqësore etj.</p>
Metodat e vlerësimit:	<p>Vlerësimi I studentëve do të bëhet përmes zbatimit të këtyre metodave:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1.Provimeve, 2. Kolokviumeve,

	<p>3.Prezantimeve, 4.Punimeve seminarike, 5.Pjesëmarrjes në debate, 6.Zgjidhjes së rasteve praktike etj.</p>
Literatura	
Literatura bazë:	<ul style="list-style-type: none"> - Hajdari Azem, E drejta e procedurës penale, Pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2014. - Hajdari Azem, E drejta e procedurës penale, Pjesa e posaçme, Prishtinë, 2013. - Hajdari Azem, Kodi i procedurës penale, Komentar, Prishtinë, 2016. - Hajdari Azem, Shkathtësitë e praktikës gjyqësore, Prishtinë, 2013. - Sahiti, Ejup, Murati Rexhep, E drejta e procedurës penale, Fakulteti Juridik, Universiteti i Prishtinës, 2013. - Sahiti, Ejup, Murati, Rexhep, Elshani, Xhevdet, Komentari i Kodit të procedurës penale, 2014.
Literatura shtesë:	<ul style="list-style-type: none"> - Krapac Davor i suradnici, Kazneno procesno pravo, Primjerovnik, Zagreb, 2001. - Krapac Davor, Kazneno procesno pravo, libri i parë: institucije, botim i dytë i ndryshuar dhe i plotësuar, Narodne Novine d.d, Zagreb, 2010. - Pavišić Berislav, Komentari Zakona o kaznenom postupku,, Rijeka, 2013. - Sijerčić-Čolić Hajrija, Krivično procesno pravo, knjiga I, Krivičnoprocesni subjekti i krivičnoprocesne radnje, Pravni fakultet Univerziteta u Sarajevu, Sarajevo, 2008. knjiga II, Tok redovnog krivičnog postupka i posebni postuci, Pravni fakultet Univerziteta u Sarajevu, Sarajevo, 2008. (1. janar 2013); - Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale (UNMIK, Rregullorja nr. 2003/26, datë 6 korrik 2003, ka hyrë në fuqi më 6 prill 2004); ndryshimet dhe plotësimet –Ligji Nr. 03/ L-003 të datës 6 nëntor 2008. - Kodi penal i Republikës së Kosovës (1 janar 2013) . - Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës (UNMIK, Rregullorja nr. 2003/25, datë 6 korrik 2003), ka hyrë në fuqi më 6 prill 2004; ndryshimet dhe plotësimet . –Ligji Nr. 03/ L-002 të datës 6 nëntor 2008. - Kodi i drejtësisë për të mitur i vitit 2010.

	<p>-Ligji penal për të miturit i Kosovës (UNMIK, Rregullorja nr. 2004/8 datë 20 prill 2004) ka hyrë në fuqi të njëjtën ditë. - Rregullorja për kryerësit e v.p. me çrregullime mendore (UNMIK, Rregullorja nr. 2004/34, datë 24 gushtë 2004) ka hyrë në fuqi të njëjtë ditë .</p> <p>- Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale i vitit 2010.</p> <p>- Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale i Kosovës (UNMIK, Rregullorja nr. 2004/46, datë 19 nëntor 2004) ka hyrë në fuqi me 19 shkurt 2005</p> <p>- Deklarata e Përgjithshme e të Drejtave të Njeriut e vitit 1948 Universal Declaration on Human Rights, G.A.res. 217 A(III), U.N. Doc. A/810 at 71</p> <p>-Pakti Ndërkombëtar i të Drejtave Civile dhe Politike me protokollet e vitit 1966 International Covenant on Civil and Political Rights, G.A. res. 2200A (XXI), 21 U.N. GAOR Supp. (No.16) at 52, U.N. Doc. A/6316 (1966), 999 U.N.T.S. 171, entered into force Mar. 23, 1976.</p> <p>- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturor i vitit 1966 International Covenant on Economic, Social and Cultural Rights G.A. res. 2200A (XXI), 21U. N. GAOR Supp (No.16) at 49, U.N. Doc. A/6316 (1966), 993 U.N.T.S. 3, entered into force Janeni 3, 1976.</p> <p>- Konventa Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriute vitit 1950, me protokollet shtesë European Convention for the Protection of Human Rights and Fundamental Freedoms, (ETS No. 5), 213 U.N.S. 222, entered into force Sept. 3,1953, as amended by Protocols No 3, 5, 8, i 11 which enterd into force on 21 September 1970, 20 December 1971, 1 January 1990, and 1 November 1998 respectively.</p>
Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	<p>Aktiviteti i policisë dhe i subjekteve tjerë në zbulimin e veprës penale dhe të kryerësit të saj. Autorizimet dhe detyrat e përgjithshme të policisë në zbulimin e veprave penale dhe të kryesve të veprave penale. Formimi i shkresave të lëndës te ndonjë rast konkret (çështje penale) të paraqitur nga policia. Paraqitja e kallëzimit penal nga policia së bashku me sendet – prova materiale, skicat, fotografitë, raportet e</p>

	marra, procesverbalet. Paraqitja e të dhënave tjera për plotësim të kallëzimit penal.
Java e dytë:	<p>Arrestimi dhe ndalimi policor, të drejtat e të dyshuarit me theks në të drejtën në mbrojtje profesionale. Marrja e vendimit mbi ndalimin policor. Analiza dhe komentet për të drejtat e të dyshuarit dhe për ndalimin policor (vështirësitë të cilat hasen në praktikë rreth arrestimit dhe ndalimit). Përpilimi i dosjes përkitazi me kufizimin elirisë. Angazhimi i mbrojtësit (nga vet i arrestuari, nga organi procedural kur me rastin e arrestimit apo të ndalimit i dyshuari-i pandehuri nuk angazhon mbrojtës neni 166 parag. 2, (neni 213 parag. 2) kur personat e tretë angazhojnë mbrojtës neni 53 parag 8 (neni 69 parag. 6).</p> <p>Të lexohen dispozitat e neneve 162, 164, 167, 171 (210-218) të KPPK. Analizat dhe komentet lidhur me mbrojtjen e të arrestuarit dhe të ndaluarit.</p> <p>Detyrë praktike: Përpilimi nga ana e studentëve: - të aktvendimit mbi ndalimin policor, - të autorizimit mbi angazhimin e mbrojtësit (nga i arrestuari, nga personat e tretë), - të vendimit mbi caktimin e mbrojtësit nga ana e personit zyrtar.</p>
Java e tretë:	<p>Vendimi i prokurorit të shtetit lidhur me bazueshmërinë e kallëzimit penal Kërkesa për plotësimin e kallëzimit penal. Pezullimi, pushimi ose shmangia nga ndjekja për vepra të lehta penale. Dërgimi eventual i çështjes penale për ndërmjetësim. Hedhja e kallëzimit pena, fillimi i hetimeve formale dhe ngritja e aktakuzës.</p> <p>-Të lexohen dispozitat e neneve 82 (208), 83 (209), 231 (227), 232 (228) të KPPK.</p>
Java e katërt:	<p>Hetimi Fillimi dhe kohëzgjatja e hetimeve. Marrja e aktvendimit mbi zbatimin e hetimeve. Veprimet hetimore (marrja në pyetje e të pandehurit, e dëshmitarëve, e ekspertëve), Mundësia hetuese e veçantë, kontrolli dhe marrja e përkohshme e sendit, këqyrja dhe rikonstruksioni, masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit, ndërprerja dhe pushimi i hetimit.</p> <p>Detyrë praktike: Hartimi i akteve nga ana e studentëve: - Aktvendimit mbi zbatimin e hetimit, - I urdhërkontrollit, - I urdhrat të prokurorit të shtetit ose urdhrat të gjyqtarit të procedurës paraprake për aplikimin e ndonjë masetë fshehtë dhe teknike të vëzhgimit dhe të hetimit,</p>

	<ul style="list-style-type: none"> - Kërkesës së të pandehurit dërguar gjyqtarit të procedurës paraprake për të marrë dëshmi nga dëshmitari apo mendim nga eksperti; etj.
Java e pestë:	<ul style="list-style-type: none"> - Thirrja gjyqësore (neni 174), - Urdhërarresti (neni 175), - Premtimi i të pandehurit se nuk do të braktisë vendqëndrimin (n. 176), - Ndalimi për t'iu afruar vendit ose personit të caktuar (n. 177), - Paraqitja në stacionin policor (n. 178), - Dorëzania (n. 179-182), - Arresti shtëpiak (n. 183), - Diversioni (neni 184) - Paraburgimi (n. 185-193 dhe zbatimi i tij nenet 194-203).
Java e gjashtë:	<p>Procedurat alternative. Aktakuza Ngritja e akuzës. Përmbajtja e aktakuzës. Analiza e dispozitave të neneve 6, 242-256 të KPPK. Detyrë praktike:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përpilimi i aktakuzës nga ana e studentëve dhe analiza e saj, - Angazhimi i mbrojtësit në gjetjen e provave për vërtetim të fakteve me të cilat do t'i kundërvihet akuzës.
Java e shtatë:	<p>Shqyrtimi gjyqësor dhe etapat e zhvillimit të tij Përgatitjet për shqyrtim gjyqësor. Fillimi i shqyrtimit gjyqësor dhe deklarimi i të akuzuarit për fajësinë. Pohimi i të akuzuarit dhe kapërcimi i procedurës provuese. Fjala përfundimtare e palëve. Mundësitë e veprimit të paditësit tëautorizuar në këtë faze.</p> <p>Detyrë praktike :</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përpilimi i urdhërit për caktimin e shqyrtimit gjyqësor; i thirrjeve gjyqësore dhe i urdhërarrestit, - Përpilimi i ndonjë aktvendimi mbi drejtimin e shqyrtimit gjyqësor.
Java e tetë:	<p>Procesi i të provuarit në shqyrtim gjyqësor Pretendimi i të akuzuarit për pafajësi. Procedimi i provave (marrja në pyetje e dëshmitarëve, e ekspertëve, leximi i shkresave, shqimi i fotodokumentacionit dhe i skicave, shikimi i gjësendeve si prove materiale etj.).</p> <p>Detyrë praktike:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Simulimi nga ana e studentëve i rolit të gjyqtarëve-kryetar dhe anëtarë të trupit gjykues dhe i rolit të dëshmitarit, - Propozimi i palës për plotësim të procedurës provuese dhe vendimi i trupit gjykues lidhur me te.
Java e nëntë:	<p>Marrja dhe shpallja e aktgjykimit dhe mundësia e atakimit të tij me ankesë. Marrja e aktgjykimit –seanca për këshillim</p>

	<p>dhe votim. Llojet e aktgjykimit (dënues, lirues refuzues.shpallja e aktgjykimit. Përpilimi me shkrim i aktgjykimit. Dërgimi i aktgjykimit palëve.</p> <p>Detyrë praktike :</p> <ul style="list-style-type: none"> - Udhëheqja e një seance për këshillim dhe votim, - Hartimi i aktgjykimeve sipas llojit të tyre në çështje të ndryshme.
Java e dhjetë:	<p>Mjetet juridike Mjetet e rregullta juridike Ankesa kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë dhe të shkallës së dytë. Personat e autorizuar për paraqitje të ankesës dhe përmbajtja e ankesës. Bazat për ushtrimin e ankesës kundër aktgjykimit. Procedura lidhur me ankesë në gjykatën e mjetit juridik dhe vendimet e kësaj gjykate. Ankesa kundër aktvendimit.</p> <p>Detyrë praktike:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Hartimi nga ana e studentëve i ankesës kundër aktgjykimit, - Hartimi dhe analizimi i vendimeve lidhur me zgjidhjen e ankesës kundër aktgjykimit të shkallës së parë.
Java e njëmbëdhjetë:	<p>Mjetet e jashtëzakonshme juridike Kërkesa për rishikim të procedurës penale. Llojet e rishikimit. Kërkesa për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit. Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë.</p> <p>Detyrë praktike:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Hartimi i kërkesë për zbatim të mjeteve të jashtëzakonshme juridike, - Hartimi i vendimit të kolegjit lidhur me lejimin apo refuzimin e kërkesës.
Java e dymbëdhjetë:	<p>Urdhri ndëshkimor dhe shqiptimi i vërejtjes gjyqësore Procedura për dhënien e urdhrin ndëshkimor. Shqiptimi i vërejtjes gjyqësore.</p> <p>Detyrë praktike:</p> <p>Hartimi i aktgjykimit me të cilën jepet vërejtja gjyqësore.</p>
Java e trembëdhjetë:	<p>Procedura për aplikimin masave për trajtim të detyrueshëm, procedura për konfiskim dhe procedura për revokim të dënimit alternative</p> <p>Masat e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik. Procedura për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm për rehabilitim ndaj personave të cilët kanë kryer vepër penale nën ndikimin e alkoolit ose të drogës.</p>
Java e katërbëdhjetë:	<p>Procedura për marrjen e vendimit mbi shlyerjen e dënimit Shlyerja e dënimit në rastet kur organi administrativ nuk</p>

	vepron. Procedura për shlyerjen e dënimit në bazë të vendimit gjyqësor.
Java e pesëmbëdhjetë:	<p>Procedura për kompensim dëmi, rehabilitim dhe realizimin e të drejtave tjera të personave të dënuar ose të arrestuar pa bazë Procedura për kompensim dëmi personave të dënuar ose të arrestuar pa bazë. Rehabilitimi i personave të dënuar apo të arrestuar pa bazë. Procedura për realizimin e të drejtave të tjera.</p> <p>Detyrë praktike :</p> <ul style="list-style-type: none"> - Hartimi i kërkesës për kompensim dëmi, për rehabilitim etj., - Hartimi i vendimit administrative përkatësisht i vendimit gjyqësor lidhur me kompensimin e dëmit.

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Përmes punës me student do të arrihet në:

1. Avancimin e dijes, ideve kreative dhe shkencës,
2. Avancojë zhvillimin e arsimit, shkencës, kulturës, shoqërisë dhe ekonomisë së Kosovës;
3. Ndihmohet në procesin e promovimit të demokracisë qytetare;
4. Krijimin dhe mbështetjen e standardeve më të larta në fushën e mësimdhënies dhe mësim nxënies si dhe kërkimeve shkencore;
5. Zhvillimin e personalitetit të shëndoshë dhe kreativ etj.